

Të birësuar (1:5)

Ted dhe Dan Spencer kanë qenë gjithë jetën e tyre nën vështimet ngulmuese të njerëzve të tjerë. Tedi, 47 vjeç dhe Dani, 36 vjeç, janë xhuxha, por kanë mbajtur një qëndrim të veçantë për këtë defekt. Në vend që të përqëndroheshin në kufizimet e tyre fizike, ata morën një vendim që u ndryshoi jetën, të adoptonin një fëmijë me probleme më të mëdha fizike. Më në fund ata adoptuan katër fëmijë jetimë me probleme fizike nga Koreja e Jugut dhe Taivani.

Tedi është njeri i qetë dhe serioz. Dani është plot gjallëri dhe i shkathët. Që të dy besojnë se fëmijët, veçanërisht ata që nuk i do njeri tjetër, do të lulëzojnë në qoftë se dikush beson në ta, i do dhe u thotë: «Mund t'ia dilni mbanë».

Do të çuditëshim po ta dinim se sa njerëz në kishë, në shkollë apo në punë kanë anëtarë të familjes që janë të adoptuar. Disa prej jush mund të keni vëllezër dhe motra që janë të adoptuar. Disa prej jush mund të keni adoptuar fëmijë. Disa prej jush mund të jeni fëmijë të adoptuar.

E vetmja mënyrë për të bërë pjesë në familjen e Perëndisë është me anë të adoptimit. Fakti se je njeri nuk të bën automatikisht anëtar të familjes së Perëndisë. Anëtarësimi në familjen e Perëndisë vjen vetëm nëpërmjet adoptimit apo, siç quhet ndryshe, birësimit.

Birësimi në familjen e Perëndisë përmendet në tre vargje të veçanta në Dhjatën e Re (Romakëve 8:15, 23, Galatasve 4:5 dhe Efesianëve 1:5). Të tre

këta vargje janë shkruar nga Pali. Te Efesianëve 1:5 thuhet: «Duke na paracaktuar që të birësohemi në veten e tij me anë të Jezu Krishtit, sipas pëlqimit të vullnetit të vet.»

Çdo kristian ka Perëndinë si At. Ne jemi birësuar. Tani jemi bijtë dhe bijat e Perëndisë. Mendoj se sfida më e madhe në jetë është që të kuptojmë me të vërtetë domethënien e këtij fakti dhe të jetojmë vërtetë si fëmijë të Perëndisë.

J. I. Packer e vuri theksin aty ku duhej:

Në qoftë se doni të gjykoni se sa mirë e kupton kristianizmin dikush, përpiquni të merrni vesh se sa e kupton ai realitetin e të qenit fëmijë i Perëndisë dhe pasjen e Perëndisë si At. Në qoftë se nuk është ky mendimi që e nxit dhe kontrollon adhurimin, lutjet dhe gjithë jetën e tij, do të thotë se ai nuk e kupton fare kristianizmin.

Birësimi në familjen e Perëndisë është bekimi më i madh frymëror i ofruar ndaj njerëzimit.

KUPTIMI I BIRËSIMIT

Pali shkroi: «Në dashuri duke na paracaktuar që të birësohemi në veten e tij me anë të Jezu Krishtit...» (1:4c–5). Pse e përdori Pali fjalën «birësim» në lidhje me kristianët? Si na ndihmon birësimi të kuptojmë se kush jemi dhe se çfarë ka bërë Perëndia për ne?

Pali po përdorte një fjalë të cilën lexuesit e kuptonin, sepse ishte një praktikë e zakonshme të jetës së asaj kohe. Birësimi ishte një ngjarje solemne.

Detajet e hollësishme të procedurave të birësimit theksonin seriozitetin e këtij veprimi. Kur një praktikë birësimi përfundonte, fëmija i birësuar kishte një identitet të ri. Studiuesi i njohur Uiliam Barklei e përshkruan këtë fakt si më poshtë:

Kur birësimi përfundonte, jeta e të birësuarit nuk ishte më si më parë. I birësuarit kishte të gjitha të drejtat e një biri të ligjshëm në familjen e re dhe i humbiste plotësisht të drejtat në familjen e vjetër. Sipas ligjit ai ishte një person i ri. Madje edhe borxhet dhe detyrimet lidhur me familjen e vjetër konsideroheshin sikur të mos kishin ekzistuar kurrë.

Pali donte që të dinim se Perëndia bëri të njëjtën gjë me ne. Para birësimit nuk ishim gjë tjetër veçse skllëvër frymërorë. Të gjithë ne ishim në borxhe të jashtëzakonshme, të shitur ndaj mëkatit, të dënuar me vdekje dhe pa Perëndinë në botë. Perëndia na deshë aq shumë, sa na çliroi, na shpëtoi dhe na birësoi!

Perëndia e bëri këtë me anë të Birit të Tij. Te Gjoni 1:12 thuhet për Jezusin: «Por të gjithëve atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij.» E drejta për t'u bërë fëmijë i Perëndisë nuk i jepet çdo njeriu. Vetëm ata që e vendosin tërë besimin e tyre në Jezusin mund të bëhen bij të vërtetë të Perëndisë.

Te Galatasve 4:4–5 thuhet: «Por, kur u mbush koha, Perëndia dërgoi Birin e tij, të lindur prej gruaje, të nënshtruar ligjit, që të shpengonte ata që ishin nën ligj, që ne të fitojmë birërinë.» Perëndia dërgoi Krishtin që ne të shpengoheshim dhe të birësoheshim në familjen e Perëndisë.

Çfarë është birësimi? Çfarë do të thotë birësim? Birësimi është çlirim nga e kaluara. Birësim do të thotë të deklarohesh nga Perëndia si fëmijë i Tij. Birësimi është diçka që Perëndia e bën për ne, e cila është edhe më e madhe se shpengimi.

Njëherë Abraham Linkoln po kalonte pranë një tregu skllëvërish dhe pa të shisnin një vajzë të vogël. Zemra e tij u pikëllua. Ai e bleu vajzën. Pasi pagoi paratë, ai i tha vajzës: «Tani je e lirë!».

«Çdo të thotë kjo?», pyeti vajza.

«Do të thotë se je e lirë», u përgjigj Linkoln.

«A do të thotë se mund të jem çfarë të dua?»

«Po! Mund të jesh çfarë të duash.»

«Do me thënë mund të shkoj ku të dua?»

«Po! Mund të shkosh ku të duash.»

Me lot në sy, vajza shkoi Linkolnin dhe tha: «Atëherë do të vij me ty.»

Perëndia e ka bërë këtë për ju. Ai ju ka çliuar. Për më tepër, Perëndia ju ka birësuar dhe ju ka bërë fëmijët e Tij.

TË MIRAT QË VIJNË NGA BIRËSIMI

Përfitimi i parë: Dashuria atërore

«...në dashuri, duke na paracaktuar që të birësohemi në veten e tij me anë të Jezu Krishtit,...» Birësimi shpreh dashurinë e Perëndisë për ne.

Dhjata e Re na ndihmon të kuptojmë masën e dashurisë së Perëndisë për ne. Ajo na jep dy mënyra për të matur dashurinë e tij të madhe. I pari është kryqi: «Por Perëndia e tregon dashurinë e Tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne» (Romakëve 5:8). A doni të dini se sa ju do Perëndia? Shikoni nga Golgota. A dëshironi të masni dashurinë e Perëndisë për ju? Mendoni për vuajtjet e Krishtit në Kryq.

Një mënyrë e dytë për të matur dashurinë e Perëndisë është dhurata e birësimit: «Shikoni ç' dashuri të madhe na dha Ati, që të quhemi bij të Perëndisë...» (1 Gjon 3:1). Nëpërmjet birësimit, ne provojmë dashurinë e Tij. Ai nuk ishte i detyruar të na shpëtonte, të na falte apo të na adoptonte. Perëndia i bëri këto nga dashuria.

Një njeri kishte shkuar në Australi për të mbajtur disa fjalime. Një ditë ai shkoi në sallonin e hotelit për të lexuar, ndërkohë që punonjësja e pastrimit po pastronte dhomën e tij. Ndërsa po u hidhte një sy shënimeve që kishte bërë, dëgjoji se dikush po i binte violinës. Nuk po përqëndrohej dot nga muzika. Më në fund, shkoi në dhomë dhe iu ankua pastrueses për muzikën.

Ajo e pyeti: «A e di se kush po i bie violinës?»

«Jo! Kush?»

«Yehudi Menuhin, violinisti më i famshëm i botës. Po përgatitet për koncertin që do japë sot në darkë.»

Burri u çudit. Nuk mund ta besonte. Menjëherë mori një karrige dhe shkoi e u ul në sallon për të dëgjuar artistin e madh që po ushtrohej. Pasi e dëgjoji, tha: «Ishte koncert i mrekullueshëm, muzika më e bukur që kam dëgjuar ndonjëherë, tani që e mora vesh kush po luante.»

Në qoftë se jeni fëmijë të Perëndisë, dëgjoni muzikën e Tij në jetën tuaj. Mos e humbisni atë. Ajo luhet pa pushim dhe pret të dëgjohet. Mbush ajrin që ne ta dëgjojmë dhe ta shijojmë. Është muzika e

dashurisë së Perëndisë. Në qoftë se do të vinim re se kush e bën atë muzikë, do ta shikonim jetën me një sy tjetër.

Përfitimi i dytë: Shpresë e vazhdueshme

Në familjen e Perëndisë më e mira pritet të vijë. Kristianizmi është besim shprese. Si fëmijë të Perëndisë, shpresojmë të marrim një trashëgimi të mrekullueshme, të garantuar nga vetë Perëndia (1:14).

Si fëmijë të Perëndisë, ne gjithashtu shpresojmë të jemi bashkëtrashëgimtarë të Krishtit dhe të lëvdohemi me të (Romakëve 8:17). Te 1 Gjon 3:2 thuhet: «Shumë të dashur, tani jemi bij të Perëndisë, por ende nuk është shfaqur ç’do të jemi; por dimë se, kur të shfaqet ai, do të jemi të ngjashëm me të, sepse do ta shohim se si është ai.»

Si fëmijë të Perëndisë, shpresojmë që një ditë të mblidhemi të gjithë së bashku me Perëndinë, në një vend të quajtur qiell. Atje do të jemi me Zotin dhe me familjen e Perëndisë përgjithmonë (1 Thesalonikasve 4:17). Kujtoni këngën që shpesh e këndojmë:

Nganjëherë qeshim së bashku,
nganjëherë qajmë;
Nganjëherë ndajmë së bashku,
dhimbjet dhe psherëtimat;
Nganjëherë endërrojmë së bashku
se si do të jetë
Kur të gjithë të shkojmë në qiell,
si familja e Perëndisë.

Këto vargje të mrekullueshme na kujtojnë se një nga përfitimet e birësimit është shpresa që kemi.

PËRGJEGJËSITË NGA BIRËSIMI

J. I. Packer tha se «e gjithë jeta kristiane duhet të kuptohet sipas kushteve të birësimit». Jezusi jetoi ashtu si jetoi, sepse e dinte kush ishte, Biri i Perëndisë. Duhet t’i japim formë jetës sonë duke patur parasysh se Perëndia është Ati ynë dhe se ne jemi fëmijët e Tij. Jezusi e theksoi këtë në predikimin në mal. Vini re se çfarë u tha Jezusi në atë predikim atyre që e njohin Perëndinë si At.

1. *Duhet të jetojmë si fëmijë të Perëndisë.* Këtë e bëjmë duke imituar Perëndinë. Jezusi tha: «Ju keni dëgjuar se qe thënë: “Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd”. Por unë po ju them: «Duani armiqtë tuaj, beconi ata që ju mallkojnë, u bëni të mira atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju

keqtrajtojnë dhe ju përndjekin, për të qenë bij të Atit tuaj, që është në qiej,...» (Mateu 5:43–45).

Të jetosh si fëmijë i Perëndisë do të thotë të imitosh Perëndinë. Do të thotë, gjithashtu, të nderosh Atin. Te Mateu 5:16 lexojmë: «Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej.»

Jetojmë si fëmijë të Perëndisë duke e imituar dhe duke e nderuar Atë, si dhe duke i vënë vetes si synim të vazhdueshëm të kënaqim Atë dhe jo njerëzit. «Mos e jepni lëmoshën tuaj para njerëzve, me qëllim që ata t’ju admirojnë; përndryshe nuk do të shpërbleheni te Ati juaj, që është në qiej» (Mateu 6:1).

2. *Duhet të lutemi si fëmijë të Perëndisë.* Si fëmijë të adoptuar i lutemi Perëndisë: «Ati ynë që je në qiej» (Mateu 6:9). Duhet të evitojmë përsëritjet e kota (Mateu 6:7–8). Mund të lutemi lirshëm dhe sa të duam: «Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet» (Mateu 7:7).

3. *Duhet të besojmë si fëmijë të Perëndisë.* Mund të jetojmë pa u shqetësuar. Duhet vetëm të besojmë se Ati ynë qiellor do të na plotësojë çdo nevojë që kemi. «Sepse janë paganët ata që kërkojnë të gjitha këto gjëra; Ati juaj qiellor, pra, e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto gjëra. Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen» (Mateu 6:32–33).

Birësimi ka përfitimet e veta, por ka edhe përgjegjësitë e veta. Shumë prej nesh i mbajnë mend prindërit duke na nxitur që të silleshim mirë në shkollë, punë apo shoqëri, për të nderuar emrin e familjes.

E njëjta gjë është e vërtetë edhe për familjen e Perëndisë. Së bashku me përfitimet vijmë edhe përgjegjësitë. Nuk mund të kemi njërën pa pasur tjetrën. Privilegji i të qenit i birësuar në familjen e Perëndisë shoqërohet me përgjegjësinë e të jetuarit si anëtarë të familjes së Perëndisë.

KONKLuzion

«Unë mendoj në fakt, se vuajtjet e kohës së tanishme nuk vlejnë aspak të krahasohen me lavdinë që do të shfaqet në ne. Sepse dëshira e flaktë e krijesës pret me padurim shfaqjen e bijve të Perëndisë» (Romakëve 8:18–19). Duket sikur të gjitha krijesat, duke përfshirë të gjitha qeniet qiellore, janë mbledhur si spektatorë që, të ethshëm,

presin të hapet perdja. Kur kjo të ndodhë në fund të kohës, të gjitha krijesat do të mbeten gojëhapur nga habia. Tingulli i reagimit të tyre ndaj lavdisë që

Perëndia u ka dhënë fëmijëve të Tij të birësuar do të dëgjohet në të gjithë universin dhe kjo do të jetë e mrekullueshme.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: "*Efesianëve*"
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara